



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO - REPUBLIC OF KOSOVO

**GJYKATA KUSHTETUESE
USTAVNI SUD
CONSTITUTIONAL COURT**

Prishtinë, më 30 shtator 2024
Nr. Ref.: RK 2540/24

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

rastin nr. KI76/24

Parashtrues

Dukagjin Haxhijaha

**Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit Pml. nr. 83/2024 të 6 marsit 2024
të Gjykatës Supreme të Kosovës**

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Gresa Caka-Nimani, kryetare
Bajram Ljatifi, zëvendëskryetar
Selvete Gërxhaliu-Krasniqi, gjyqtare
Safet Hoxha, gjyqtar
Radomir Laban, gjyqtar
Remzije Istrefi-Peci, gjyqtare
Nexhmi Rexhepi, gjyqtar
Enver Peci, gjyqtar dhe
Jeton Bytyqi, gjyqtar

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është parashtruar nga Dukagjin Haxhijaha, nga Prishtina, të cilin e përfaqëson Lendita Keqekolla-Gashi, avokate nga Prishtina (në tekstin e mëtejme: parashtruesi i kërkesës).

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi i kërkesës e konteston kushtetutshmërinë e Aktgjykimit [Pml.nr. 83/2024] të 6 marsit 2024 të Gjykatës Supreme të Kosovës [në tekstin e mëtejme: Gjykata Supreme], në ndërlidhje me Aktgjykimin [PAL. nr. 888/2023] e 23 tetorit 2023 të Gjykatës së Apelit të Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata e Apelit) dhe Aktgjykimin [P. nr. 819/2019] e 18 prillit 2023 të Gjykatës Themelore në Prishtinë (në tekstin e mëtejme: Gjykata Themelore).

Objekti i çështjes

3. Objekt i çështjes së kërkesës është vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit [Pml. nr. 83/2024] të 6 marsit 2024, të Gjykatës Supreme, përmes së cilës parashtruesi i kërkesës pretendon se i janë shkelur të drejtat e garantuara me nenet: 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm], 32 [E Drejta për Mjete Juridike], 54 [Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave], 55 [Kufizimi i të Drejtave dhe Lirive Themelore] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kushtetuta), në lidhje me nenin 6 (E drejta për një proces të rregullt) të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejme: KEDNJ).

Baza juridike

4. Kërkesa bazohet në paragrafët 1 dhe 7 të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, në nenet 22 (Procedimi i kërkesës) dhe 47 (Kërkesa individuale) të Ligjit nr. 03/L-121 për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Ligji) dhe në rregullin 25 (Parashtrimi i kërkesave dhe përgjigjeve) të Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese (në tekstin e mëtejme: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

5. Më 27 mars 2024, parashtruesi i kërkesës e dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata).
6. Më 3 prill 2024, Kryetarja e Gjykatës me Vendimin [nr. GJR. KI76/24] caktoi gjyqtaren Remzije Istrefi-Peci, gjyqtare raportuese dhe me Vendimin [KSH. KI76/24] caktoi anëtarët e Kolegjit shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Selvete Gërzhaliu- Krasniqi (kryesuese), Safet Hoxha dhe Radomir Laban (anëtarë).
7. Më 24 prill 2024, Gjykata e njoftoi parashtruesin e kërkesës për regjistrimin e kërkesës. Të njëjtën datë, një kopje e kërkesës iu dërgua Gjykatës Supreme.
8. Më 4 shtator 2024, Kolegji shqyrtues shqyrtoi raportin e gjyqtarës raportuese dhe njëzëri i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

9. Nga shkresat e lëndës rezulton që, më 23 mars 2006, Prokuroria e Qarkut në Prishtinë kishte ngritur aktakuzë kundër parashtruesit të kërkesës, për shkak të veprës penale "Rrezikimi i trafikut publik" sipas nenit 297, paragrafi 5 lidhur me paragrafin 3 të Kodit të Përkohshëm Penal të Kosovës (në tekstin e mëtejme: KPPK). Më 25 nëntor 2016, përmes Aktgjykimit [P. nr. 3728/2013] Gjykata Themelore e shpalli fajtor parashtruesin e kërkesës dhe ia shqiptoi dënimin prej 1 (një) vit e (6) gjashtë muaj burgim. Gjykata e Apelit përmes Aktvendimit [PA1. nr. 108/2017] të 7 marsit 2017 e kishte aprovuar ankesën e parashtruesit të kërkesës dhe ktheu çështjen në rigjykim. Në rigjykim, më 24 gusht 2018, Gjykata Themelore përmes Aktgjykimit [P. nr. 1566/2017] e shpalli fajtor

parashtruesin e kërkesës dhe ia shqiptoi dënimin prej 1 (një) viti e 6 (gjashtë) muaj burgim. Më 21 shkurt 2019, Gjykata e Apelit përmes Aktvendimit [PA1. nr. 1326/18] aprovoi ankesën e parashtruesit të kërkesës dhe e ktheu çështjen përsëri në rigjykim.

10. Më 18 prill 2023, Gjykata Themelore përmes Aktgjykimit [P. nr. 819/19] e shpalli fajtor parashtruesin e kërkesës për shkak të veprës penale “Rrezikimi i trafikut publik” nga neni 297, paragrafi 5 lidhur me paragrafin 3 të KPPK-së dhe i a shqiptoi dënimin me burgim në kohëzgjatje prej 1 (një) viti. Gjykata Themelore me atë rast arsyetoi se, parashtruesi i kërkesës duke vozitur automjetin e tij përtej shpejtësisë së lejuar në zonën ku ndodhi aksidenti, e kishte humbur kontrollin mbi automjetin dhe e kishte goditur një shtyllë elektrike. Në veturën e tij kishin qenë V.M. dhe K.H. të cilët kishin arritur të shpëtonin nga zjarri që e kishte përfshirë automjetin, ndërkaq viktima Z.H. nuk kishte arritur të dilte nga automjeti dhe kishte vdekur nga zjarri. Gjykata Themelore vlerësoi se, ekspertiza e komunikacionit tregoi që shkaktari i aksidentit ishte shpejtësia më e lartë e vozitjes sesa lejohej sipas rregullave të komunikacionit: 71.6 km/h në një vend ku lejohej vetëm 60 km/h. Gjykata Themelore argumentoi po ashtu se sipas ekspertizës mjeko-ligjore, teshtima e parashtruesit të kërkesës gjatë vozitjes ka mundur të ishte shkaktar i aksidentit, mirëpo po të ishte shpejtësia e lëvizjes sipas normave të përcaktuara atëherë parashtruesi i kërkesës nuk do ta humbiste kontrollin ndaj automjetit dhe në rast aksidenti pasojat do të ishin dukshëm më të vogla.
11. Parashtruesi i kërkesës paraqiti ankesë në Gjykatën e Apelit kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore, me pretendimin se provat e administruara nuk ishin vlerësuar si duhet. Parashtruesi i kërkesës theksoi se teshtima ishte shkaktar i aksidentit dhe kjo gjë u konstatua edhe nga raporti i ekspertizës mjeko-ligjore dhe ekspertizës së komunikacionit, mirëpo Gjykata Themelore nuk i mori parasysh këto ekspertiza dhe nuk i vlerësoi si duhet.
12. Më 23 tetor 2023, Gjykata e Apelit përmes Aktgjykimit [PA1. nr. 888/2023] e refuzoi ankesën e parashtruesit të kërkesës si të pabazuar dhe vërtetoi aktgjykimin e Gjykatës Themelore. Gjykata e Apelit vlerësoi se ekspertiza e komunikacionit kishte treguar që shkaktari i aksidentit ishte shpejtësia më e madhe e lëvizjes së automjetit sesa ishte e lejuar në zonën ku ndodhi aksidenti; nëse vozitja do të ishte brenda kufizimit të lejuar atëherë edhe po të ndodhte teshtitja nuk do të humbej kontrolli mbi drejtimin e automjetit. Për më tepër, skica e Policisë në vendin e ngjarjes dëshmoi se nuk kishte gjurmë të frenimit të automjetit, por vetëm lëvizje zik-zake të automjetit nga një shirit në shiritin tjetër deri në goditjen e shtyllës elektrike dhe djegien e automjetit nga zjarri. Gjykata e Apelit vlerësoi se dëshmitari K.H., menjëherë pas aksidentit në vitin 2005, në stacionin policor kishte deklaruar se parashtruesi i kërkesës e kishte humbur kontrollin mbi drejtimin e automjetit dhe e kishte goditur shtyllën elektrike; pas 11 vitesh, në seancën gjyqësore në vitin 2016, i njëjti dëshmitar e kishte përmendur për herë të parë teshtitjen si shkaktar të aksidentit, mirëpo një gjë e tillë nuk ishte e besueshme për shkak të kohës së gjatë të kaluar dhe ndryshimit të deklaratave. Edhe dëshmitari tjetër që ishte në automjet në ditën e aksidentit V.M., kishte deklaruar se parashtruesi i kërkesës në momentin e aksidentit kishte vozitur në mënyrë zik-zake dhe e kishte goditur shtyllën elektrike e cila i ndante dy koristë e rrugës ku ndodhi aksidenti.
13. Parashtruesi i kërkesës paraqiti në Gjykatën Supreme kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë, me pretendimin se gjykatat e instancave më të ulëta nuk i morën parasysh ekspertizat e administruara gjatë procesit gjyqësor dhe nuk e vlerësuan teshtitjen e parashtruesit të kërkesës gjatë drejtimit të automjetit - si një proces natyror që nuk mund të parashihet se në cilin moment do të paraqitet, si prova kryesore në këtë çështje.
14. Më 6 mars 2024, Gjykata Supreme përmes Aktgjykimit [Pml. nr. 83/2024] e refuzoi kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë së parashtruesit të kërkesës dhe vërtetoi

aktgjykimet e gjykatave më të ulëta. Së pari, Gjykata Supreme vlerësoi se dëshmitarët që ishin në automjet, në kohën e aksidentit, nuk e kishin përmendur çështjen e teshtitjes së parashtruesit të kërkesës si shkaktar të aksidentit. Së dyti, ekspertiza e komunikacionit tregoi se parashtruesi i kërkesës kishte vozitur automjetin me shpejtësi më të lartë sesa lejohej dhe e kishte humbur kontrollin e drejtimit të automjetit; ai kishte manovruar me timon hovshëm dhe kishte kaluar në shiritin tjetër të lëvizjes duke e goditur shtyllën elektrike. Së treti, ekspertiza mjeko-ligjore kishte analizuar procesin e teshtitjes duke e paraqitur si shkaktar të mundshëm të aksidentit, mirëpo nuk e kishte konstatuar që në rastin konkret teshtitja e parashtruesit të kërkesës ishte faktori që shkaktoi aksidentin. Gjykata Supreme theksoi se vlerësimi i provave është përgjegjësi në radhë të parë e shkallës së parë e në disa raste edhe e shkallës së dytë; dhe në rastin konkret gjykatat e shkallëve më të ulëta dhanë vlerësime të qëndrueshme mbi provat e administruara.

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

15. Parashtruesi i kërkesës pretendon që vendimet e gjykatave të rregullta janë në kundërshtim me nenet 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm], 32 [E Drejta për Mjete Juridike], 54 [Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave] dhe 55 [Kufizimi i të Drejtave dhe Lirive Themelore] të Kushtetutës.

Pretendimi për shkeljen e nenit 31 të Kushtetutës

(i) Në lidhje me arsyetimin e vendimit

16. Parashtruesi i kërkesës pretendon që Gjykata e Apelit nuk ofroi arsyetime të mjaftueshme dhe adekuate kur e refuzoi ankesën e tij kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore. Sipas tij, Gjykata e Apelit nuk i ka kushtuar vëmendje të mjaftueshme vërtetimit të fakteve kryesore të mbështetura në ligj. Parashtruesi i kërkesës thekson se *“arsyetimi i vendimit duhet domosdoshmërisht të plotësojë kriteret bazike dhe të mos ketë të meta të tilla serioze që cenojnë standardin e vendimit gjyqësor të arsyetuar dhe mungesën e arsyeve lidhur me faktet vendimtare”*.
17. Parashtruesi i kërkesës thekson se, arsyetimi i vendimit është pjesë e të drejtës për gjykim të drejtë dhe të paanshëm, të garantuar me nenin 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNj-së. Arsyetimi i vendimit nënkupton që gjykatat janë të obliguara të bëjnë arsyetimin e të gjitha pikave të vendimeve të tyre dhe të japin përgjigje për pretendimet e palëve në mënyrë të qartë.
18. Parashtruesi i kërkesës pretendon se aktgjykimi i Gjykatës së Apelit, që refuzoi ankesën e parashtruesit të kërkesës, është në kundërshtim me nenin 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNj-së.

(ii) Në lidhje me vlerësimin e provave

19. Parashtruesi i kërkesës pretendon se: *“Gjykatat e instancës më të ulët nuk i kanë vlerësuar fare ekspertizat dhe mendimet e ekspertëve, e sidomos nuk kanë vlerësuar fare faktin kryesor teshtitjen, i cili është proces natyral dhe nuk mund të parashikohet se në cilin moment mund të ndodhë e po ashtu nuk mund të kontrollohet as në momentin kur vozitësi është duke ngasur automjetin. Andaj gjykatat nuk patën parasysh këtë fakt e cila në këtë çështje është prova më kryesore për marrjen e një vendimi të drejtë dhe meritore po ashtu të arsyetuar mirë”*.

Dispozitat relevante kushtetuese dhe ligjore

Kushtetuta e Republikës së Kosovës
Neni 31
[E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm]

1. Çdokujt i garantohet mbrojtje e barabartë e të drejtave në procedurë para gjykatave, organeve të tjera shtetërore dhe bartësve të kompetencave publike.
 2. Çdokush gëzon të drejtën për shqyrtim publik të drejtë dhe të paanshëm lidhur me vendimet për të drejtat dhe obligimet ose për cilëndo akuzë penale që ngrihet kundër saj/tij brenda një afati të arsyeshëm, nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e themeluar me ligj.
- [...]

Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut

Neni 6
(E drejta për një proces të rregullt gjyqësor)

1. Çdo person ka të drejtë që çështja e tij të dëgjohet drejtësisht, publikisht dhe brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e krijuar me ligj, e cila do të vendosë si për mosmarrëveshjet në lidhje me të drejtat dhe detyrimet e tij të natyrës civile, ashtu edhe për bazueshmërinë e çdo akuze penale në ngarkim të tij. Vendimi duhet të jepet publikisht, por prania në sallën e gjykatës mund t'i ndalohet shtypit dhe publikut gjatë tërë procesit ose gjatë një pjese të tij, në interes të moralit, të rendit publik ose sigurisë kombëtare në një shoqëri demokratike, kur kjo kërkohet nga interesat e të miturve ose mbrojtja e jetës private të palëve në proces ose në shkallën që çmohet tepër e nevojshme nga gjykata, kur në rrethana të veçanta publiciteti do të dëmtonte interesat e drejtësisë.

KAPITULLI XXVI: VEPRAT PENALE KUNDËR SIGURISË SË TRAFIKUT PUBLIK

Neni 297
RREZIKIMI I TRAFIKUT PUBLIK

2. Kushdo që shkel ligjin mbi trafikun publik dhe rrezikon trafikun publik, jetën e njerëzve apo pasurinë me përmasa të mëdha dhe me këtë i shkakton lëndime të lehta trupore personit apo dëm thelbësor material që tejkalon vlerën mbi 1.000 euro dënohet me gjobë apo me burgim deri në pesë vjet.
3. [...]
4. Nëse vepra penale nga paragrafi 1 ose 2 i këtij neni kryhet nga pakujdesia, kryerësi dënohet me gjobë apo me burgim deri në dy vjet.
5. [...]
6. Nëse vepra penale nga paragrafi 3 i këtij neni rezulton me lëndim të rëndë trupor ose me dëm thelbësor material, kryerësi dënohet me burgim prej gjashtë muajve deri në pesë vjet, e nëse vepra e tillë penale rezulton me vdekjen e një apo të më shumë personave, kryerësi dënohet me burgim prej një deri në tetë vjet.

Vlerësimi i pranueshmërisë së kërkesës

20. Gjykata së pari vlerëson nëse parashtruesi i kërkesës i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë, të përcaktuara në Kushtetutë dhe të parashikuara më tej në Ligj dhe në Rregullore të punës.

21. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet paragrafëve 1 dhe 7 të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, në lidhje me paragrafin 4 të nenit 21 [Parimet e Përgjithshme] të Kushtetutës, që përcaktojnë:

Neni 113

[Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara]

“1. Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar.

[...]

7. Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj”.

[...]

22. Gjykata në vazhdim shqyrton nëse parashtruesi i kërkesës i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë, siç përcaktohen më tutje në Ligj, përkatësisht me nenet 47 dhe 48 të Ligjit, që përcaktojnë:

Neni 47

(Kërkesa individuale)

“1. Çdo individ ka të drejtë të kërkojë nga Gjykata Kushtetuese mbrojtje juridike në rast se pretendon se të drejtat dhe liritë e tija individuale të garantuara me Kushtetutë janë shkelur nga ndonjë autoritet publik.

2. Individ i mund ta ngritë kërkesën në fjalë vetëm pasi që të ketë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj”.

Neni 48

(Saktësimi i kërkesës)

“Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësoj saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestoj”.

Neni 49

(Afatet)

“Kërkesa parashtrohet brenda afatit prej katër (4) muajve. Afati fillon të ecë që nga dita kur parashtruesit i është dorëzuar vendimi gjyqësor. Në të gjitha rastet e tjera, afati fillon të ecë në ditën kur vendimi ose akti është shpallur publikisht ...”.

23. Përkitazi me përmbushjen e kriterëve të lartcekura, Gjykata vlerëson se parashtruesi i kërkesës është palë e autorizuar, në kuptim të nenit 113.7 të Kushtetutës; parashtruesi i kërkesës konteston kushtetutshmërinë e një akti të një autoriteti publik, përkatësisht Aktgjykimin [Pml. nr. 83/2024] e Gjykatës Supreme, të 6 marsit 2024, pasi i ka shteruar të gjitha mjetet juridike në dispozicion, sipas nenit 113.7 të Kushtetutës dhe nenit 47.2 të Ligjit; ka specifikuar të drejtat e garantuara me Kushtetutë, të cilat pretendon se i janë shkelur, në pajtim me kërkesat e nenit 48 të Ligjit; dhe kërkesën e ka parashtruar brenda afatit ligjor prej 4 (katër) muajve, siç parasheh neni 49 i Ligjit.
24. Përveç kësaj, Gjykata shqyrton nëse parashtruesi i kërkesës i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë të përcaktuara me nënregullin (2) të rregullit 34 [Kriteret e pranueshmërisë] të Rregullores së punës, që përcakton:

Rregulli 34
(Kriteret e pranueshmërisë)

(2) “Gjykata mund ta konsiderojë kërkesën të papranueshme, nëse kërkesa është qartazi e pabazuar, ku parashtruesi/ja nuk dëshmon dhe nuk mbështet në mënyrë të mjaftueshme pretendimin e tij/saj”.

[...]

25. Bazuar në praktikën gjyqësore të GjEDNj-së, por edhe të Gjykatës, një kërkesë mund të shpallet e papranueshme si “qartazi e pabazuar” në tërësinë e saj ose vetëm përkitazi me ndonjë pretendim specifik që një kërkesë mund të ngërthejë. Në këtë drejtim, është më e saktë t’iu referohet të njëjtave, si “pretendime qartazi të pabazuara”. Këto të fundit, bazuar në praktikën gjyqësore të GjEDNj-së, mund të kategorizohen në katër grupe të veçanta: (i) pretendime që kategorizohen si pretendime “të shkallës së katërt”; (ii) pretendime që kategorizohen me një “mungesë të dukshme ose evidente të shkeljes”; (iii) pretendime “të pambështetura apo të paarsyetuara”, atëherë kur plotësohet njëri nga dy nënkriteret, në vijim: a) kur parashtruesi/ja i/e kërkesës thjesht citon një ose disa dispozita të Konventës apo të Kushtetutës, pa shpjeguar mënyrën se si ato janë shkelur, përveç nëse në bazë të fakteve dhe rrethanave të rastit qartazi duket shkelja e Kushtetutës dhe KEDNj-së (shih rastin e GjEDNj-së [Trofimchuk kundër Ukrainës](#), nr. 4241/03, vendimi i 31 majit 2005; shih gjithashtu [Baillard kundër Francës](#), nr. 6032/04, vendimi i 25 shtatorit 2008); dhe b) kur parashtruesi/ja i/e kërkesës nuk paraqet ose refuzon të paraqesë prova materiale, me të cilat do t’i mbështeste pretendimet e tij/saj (kjo posaçërisht vlen për vendimet e gjykatave ose të autoriteteve të tjera të brendshme), përveç rasteve kur ekzistojnë rrethana të jashtëzakonshme që janë jashtë kontrollit të tij dhe të cilat e pengojnë atë ta bëjë këtë (për shembull, kur administrata e burgut refuzon t’ia paraqesë Gjykatës dokumentet nga dosja e një të burgosuri për të cilin bëhet fjalë) ose nëse Gjykata vet nuk vendos ndryshe (shih rastin e Gjykatës [KI166/20](#), parashtrues, *Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale*, Aktvendim për papranueshmëri, i 5 janarit 2021, paragrafi 43), dhe në fund, (iv) pretendime “konfuze dhe të paqarta” (shih rastet e GjEDNj-së, [Kemmaché kundër Francës](#), nr. 17621/91, Aktgjykimi i 24 nëntorit 1994, kategoria (i), [Juta Mentzen kundër Lituanisë](#), nr. 71074/01, vendimi i 7 dhjetorit 2004, kategoria (ii) dhe [Trofimchuk kundër Ukrainës](#), Aplikimi nr. 4241/03, kategoria (iii).
26. Gjykata thekson se pretendimi kryesor i parashtruesit të kërkesës është shkelja e nenit 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së, përkitazi me arsyetimin e vendimeve gjyqësore dhe vlerësimit të provave. Parashtruesi i kërkesës e ka përmendur edhe nenin 32 dhe 54 të Kushtetutës, mirëpo vetëm i ka cituar pa ngritur asnjë çështje konkrete dhe duke i ndërlidhur me pretendimin e tij kryesor. Prandaj, Gjykata do t’i trajtojë vetëm pretendimet kryesore të parashtruesit të kërkesës në lidhje me arsyetimin e vendimeve dhe vlerësimin e provave.
27. Gjykata thekson se parashtruesi i kërkesës e konteston Aktgjykimin [Pml. nr. 83/2024] e 6 marsit 2024 të Gjykatës Supreme, duke pretenduar shkelje të të drejtave të tij sepse aktgjykimi i Gjykatës Supreme të Kosovës nuk ka adresuar shkeljet që kanë ndodhur në procedurën pranë Gjykatës së Apelit. Në këtë drejtim, pretendimet kryesore të parashtruesit të kërkesës lidhen me Aktgjykimin [PAL. nr. 888/2023] e 23 tetorit 2023 të Gjykatës së Apelit, përkitazi me mosarsyetimin e vendimit gjyqësor, si dhe mosvlerësim të provave të parashtruara nga ai.

Pretendimi për shkeljen e nenit 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNj-së

28. Parashtruesi i kërkesës pretendon se Aktgjykimi [PAL. nr. 888/23] i 23 tetorit 2023 i Gjykatës së Apelit nuk ofroi arsytim të mjaftueshëm dhe adekuat sipas standardeve kushtetuese; dhe se gjykatat e rregullta nuk i vlerësuan në mënyrë të drejtë provat, respektivisht raportet e ekspertizave që ishin në favor të tij.

(i) Në lidhje me arsyetimin e vendimeve

29. Parashtruesi i kërkesës pretendon që Gjykata e Apelit nuk dha arsytime të mjaftueshme – kur vendosi të refuzojë ankesën e tij kundër aktgjyimit të Gjykatës Themelore. Në lidhje me këtë pretendim parashtruesi (i) i referohet dhe citon përmbajtjen e nenit 31; (ii) i referohet praktikës gjyqësore të Gjykatës dhe GJEDNj-së; (iii) pretendon se në rastin konkret, duke mos arsyetuar vendimin gjyqësor është shkelur neni 53 i Kushtetutës. Rrjedhimisht, sipas parashtruesit të kërkesës “*defektet e sipërpërmendura juridike të aktvendimit të Gjykatës së Apelit cenojnë seriozisht të drejtën kushtetuese për gjykim të drejtë e garantuar me nenin 31 të Kushtetutës së Kosovës dhe nenin 6, para. 1 të KEDNj-së*”.

30. Fillimisht, Gjykata rithekson se gjykatat e rregullta e kanë detyrim të paraqesin arsytime të mjaftueshme për vendimet e tyre. Vendimet e arsyetuara gjyqësore i tregojnë palëve që rasti i tyre është shqyrtuar me të vërtetë. Përkundër faktit që gjykatat e rregullta kanë liri të caktuar të vlerësimit lidhur me përzgjedhjen e argumenteve dhe vendosjes për pranueshmërinë e dëshmimeve, ato detyrohen t'i arsyetojnë të gjitha vendimet (shih, rastet e Gjykatës, [KI137/23](#), parashtrues *Naim Berisha*, Aktgjykim i 18 janarit 2024, paragrafët 48-58; [KI230/19](#), parashtrues *Albert Rakipi*, Aktgjykim i 9 dhjetorit 2020 paragrafët 135-138).

31. Gjykata ripërsërit se detyrimi për të dhënë arsytime mund të ndryshojë varësisht nga natyra e vendimit dhe duhet të përcaktohet sipas rrethanave të rastit konkret. Argumentet kryesore të palëve që mund të jenë vendimtare për rezultatin e procesit gjyqësor duhet të adresohen dhe të arsyetohen (shih, rasti i Gjykatës, [KI148/21](#), parashtrues *Fatos Dervishaj*, Aktvendim për papranueshmëri i 31 marsit 2022, paragrafët 44-47; rasti i GJEDNj-së, [Aykhan Akhundov kundër Azerbejxhanit](#), nr. 43467/06, aktgjykim i 1 qershorit 2023, para. 86-87; [Buzescu kundër Rumanisë](#), nr. 61302/00, aktgjykim i 24 majit 2005, para. 67).

32. Në rastin konkret, Gjykata vëren se parashtruesi i kërkesës u shpall fajtor nga Gjykata Themelore për shkak të veprës penale “Rrezikimi i trafikut publik” sipas KPPK-së dhe u dënua me burgim në kohëzgjatje prej 1 (një) viti. Gjykata Themelore arsyetoi se parashtruesi i kërkesës duke drejtuar automjetin e tij përtej shpejtësisë së lejuar, u përplas me shtyllën elektrike dhe si rezultat i aksidentit ndërroi jetë viktima Z.H., e cila u përfshi nga zjarri.

33. Parashtruesi i kërkesës kishte ngritur pretendimin se gjatë drejtimit të automjetit kishte teshtitë dhe si rezultat e kishte humbur kontrollin mbi automjetin. Mbrojtja pretendonte se procesi i teshtitjes është proces natyral dhe i pakontrollueshëm prandaj nuk ekzistonte përgjegjësia penale e parashtruesit të kërkesës.

34. Në lidhje me këtë pretendim, Gjykata vëren që Gjykata Themelore në Aktgjykimin [P. nr. 819/19] e 18 prillit 2023, arsyetoi se ekspertiza e komunikacionit tregoi që shkaktari i aksidentit në rastin konkret ishte shpejtësia e drejtimit të automjetit: parashtruesi i kërkesës në momentin e drejtimit të automjetit ishte duke lëvizur me shpejtësi 71.6 km/h, në një zonë ku shpejtësia e lejuar ishte vetëm 60.0 km/h. Kjo bëri që automjeti

të përplasej me një shtyllë elektrike dhe të shkaktohej aksidenti ku humbi jetën viktima Z.H., për shkak të djegies nga zjarri që e përfshiu automjetin. Gjykata Themelore theksoi se, ekspertiza mjeko-ligjore tregoi që teshtitja mund të ndikojë në shkaktimin e aksidentit, mirëpo në rastin konkret nuk ishte vërtetuar një gjë e tillë. Ekspertiza mjeko-ligjore nuk ishte marrë me faktin nëse parashtruesi i kërkesës kishte teshtitë gjatë drejtimit të automjetit dhe ishte shkaktuar aksidenti, por me analizimin nëse teshtitja si fenomen mund të jetë shkaktar i aksidentit. Gjykata Themelore vlerësoi se edhe po të shkaktohej aksidenti nga teshtitja e parashtruesit të kërkesës, nëse automjeti do të drejtohej brenda shpejtësisë së lejuar pasojat do të ishin shumë më të vogla dhe nuk do të humbej kontrolli i automjetit.

35. Gjykata e Apelit në Aktgjykimin [PAL. nr. 888/23] e 23 tetorit 2023, arsyetoi se ekspertiza mjeko-ligjore kishte konstatuar që teshtitja zakonisht përcillet me mos përmbytje momentale dhe mbyllje të syve për një kohë shumë të shkurtër, mirëpo nëse vozitja do të ishte në shpejtësinë e lejuar dhe sipas kushteve të rrugës, edhe po të kishte ndodhur teshtitja nuk do të humbej kontrolli i automjetit dhe pasojat do të ishin shumë më të vogla. Gjykata e Apelit theksoi po ashtu se procesverbali i hartuar në vendin e ngjarjes dhe skicimi nga Policia e Kosovës treguan që parashtruesi i kërkesës nuk e kishte frenuar automjetin por ishin gjetur gjurmë të lëvizjes zik-zake deri në goditjen e shtyllës elektrike. Për më tepër, dy dëshmitarët të cilët ishin në automjet në kohën e aksidentit dhe kishin arritur të shpëtonin, në dëshmitë e tyre nuk kishin deklaruar se parashtruesi i kërkesës kishte teshtitë gjatë drejtimit të automjetit. Njëri prej tyre pas shumë vitesh e ndryshoi deklaratën e tij të dhënë në stacionin policor pas aksidentit, dhe deklaroi që parashtruesi kishte teshtitë. Mirëpo, gjykatat e rregullta nuk e vlerësuan kredibile dëshminë e tij për shkak të ndryshimit të deklaratës dhe vendosën të merrnin parasysh deklaratën e tij fillestare, gjë që mund të konsiderohet e arsyeshme.
36. Bazuar në si më lartë, Gjykata thekson që gjykatat e rregullta dhanë arsyetime të mjaftueshme në lidhje me shkaktarin e aksidentit dhe përgjegjësinë penale të parashtruesit të kërkesës; dhe përmbyshën detyrimin e tyre për arsyetim të vendimit në përputhje me nenin 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNj-së.
37. Gjykata konstaton se pretendimet e parashtruesit të kërkesës për shkeljen e nenit 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNj-së, përkritazi me mos arsyetimin e vendimit gjyqësor, i përkasin pretendimeve “*me mungesë të dukshme ose evidente të shkeljes*”, dhe rrjedhimisht shpallen si qartazi të pabazuara, bazuar në nenin 34 (2) të rregullores së punës.

(ii) Në lidhje me vlerësimin e provave

38. Parashtruesi i kërkesës pretendon se gjykatat e rregullta nuk i vlerësuan në mënyrë të drejtë provat, respektivisht raportet e ekspertizave - të cilat treguan se shkaktari i aksidentit ishte teshtitja gjatë drejtimit të automjetit, mirëpo nuk u morën parasysh nga gjykatat e rregullta.
39. Gjykata rithekson se çështja e administrimit të provave, pranueshmëria dhe vlerësimi i tyre është pjesë e juridiksionit të gjykatave të rregullta. Gjykata nuk mund të vlerësojë nëse provat e administruara ishin të mjaftueshme për shpalljen fajtorë të parashtruesve të kërkesës (shih, rasti i Gjykatës, KI92/23, [parashtrues Mimoza Pajaziti](#), Aktvendim për papranueshmëri i 31 janarit 2024, paragrafët 43-45). Gjykata përsërit se në lidhje me administrimin e provave, e rëndësishme është nëse mënyra se si janë mbledhur provat ka qenë e rregullt në tërësi. Po ashtu, rëndësi ka nëse parashtruesi ka pasur mundësi të kontestojë ligjshmërinë e provave dhe të paraqes kundërshtimet ndaj përdorimit të tyre. Sipas GjEDNj-së, duhet shikuar nëse një provë e caktuar ka qenë apo jo përcaktuese për rezultatin e procesit penal (shih, rasti i Gjykatës, KI122/19,

[parashtrues F.M.](#), Aktvendim për papranueshmëri i 9 korrikut 2020, paragrafët 66-69). Gjykata rithekson se gjykatat e rregullta gëzojnë diskrecion se cilat argumente dhe prova i pranojnë dhe i falin besim, në raport me provat e tjera. Mirëpo, për një gjë të tillë duhet të japin arsyetimet e tyre (shih, rasti i Gjykatës, KI34/18, [parashtrues Albert Berisha](#), Aktvendim për papranueshmëri i 23 majit 2018, paragrafi 50-51).

40. Gjykata vëren se, çështja kontestuese në këtë rast ishte shkaktari i aksidentit dhe përgjegjësia penale e parashtruesit të kërkesës. Për këtë qëllim, gjykatat e rregullta administruan dhe vlerësojnë një numër të caktuar të provave, përfshirë ekspertizën e komunikacionit, ekspertizën mjeko-ligjore dhe dëshmitë e dëshmitarëve.
41. Parashtruesi i kërkesës pretendonte se shkaktari i aksidentit ishte teshtitja gjatë drejtimit të automjetit. Ai e ngriti këtë pretendim në të gjitha instancat gjyqësore.
42. Gjykata vëren se, ekspertiza mjeko-ligjore nuk ishte marrë me faktin nëse në rastin konkret parashtruesi i kërkesës kishte teshtitë gjatë drejtimit të automjetit, por vetëm kishte analizuar procesin e teshtitjes si shkaktar i mundshëm i çfarëdo aksidenti. Rrjedhimisht, ekspertiza mjeko-ligjore nuk kishte konstatuar që parashtruesi i kërkesës kishte teshtitë gjatë drejtimit të automjetit dhe që kjo të kishte shkaktuar aksidentin.
43. Për të treguar shkaktarin e aksidentit, gjykatat e rregullta u bazuan në ekspertizën e komunikacionit, e cila tregoi se shkaktari i aksidentit ishte shpejtësia e drejtimit të automjetit nga parashtruesi i kërkesës përtej normave të lejuara në atë zonë. Gjykatat e rregullta arsyetuan se, nëse lëvizja e automjetit do të ishte brenda normave të lejuara, edhe në rast të aksidentit, pasojat do të ishin dukshëm më të vogla.
44. Gjykata thekson se gjykatat e rregullta e kanë autoritetin për të vendosur në lidhje me administrimin e provave dhe vlerësimin e tyre. Parashtruesi i kërkesës kishte mundësi që gjatë procesit gjyqësor të paraqiste kundërshtimet e tij në lidhje me vlerësimin e provave në të gjitha instancat. Procesi gjyqësor përkitazi me administrimin dhe vlerësimin e provave ishte i drejtë dhe nuk shkeli të drejtat e parashtruesit të kërkesës, të garantuara me nenin 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së.
45. Gjykata konstaton se pretendimet për shkeljen e nenit 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së, përkitazi me vlerësimin e provave, i përkasin pretendimeve të “*shkallës së katërt*”, dhe rrjedhimisht shpallen si qartazi të pabazuara, bazuar në nenin 34 (2) të Rregullores së punës.

Pretendimi për shkeljen e nenit 32, 54 dhe 55 të Kushtetutës

46. Parashtruesi i kërkesës pretendon edhe shkeljen e nenit 32, 54 dhe 55 të Kushtetutës. Gjykata vëren se, parashtruesi i kërkesës vetëm i ka përmendur dhe cituar këto nene të Kushtetutës mirëpo nuk ngrit asnjë çështje konkrete dhe nuk ofron argumente se si janë shkelur këto të drejta nga vendimet e gjykatave të rregullta.
47. Gjykata rithekson se, vetëm përmendja dhe citimi i neneve të Kushtetutës nuk është e mjaftueshme për të ngritur pretendime për shkelje kushtetuese (shih, rastin e Gjykatës, [KI119/21](#), [parashtrues Ahmet Hoti dhe të tjerët](#), Aktvendim për papranueshmëri i 22 qershorit 2022, paragrafët 93-94).
48. Gjykata konstaton se pretendimet e parashtruesit të kërkesës për shkeljen e nenit 32, 54 dhe 55 të Kushtetutës, i përkasin pretendimeve “*të pambështetura apo të paarsyeturara*”, dhe rrjedhimisht shpallen si qartazi të pabazuara.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me paragrafin 1 dhe 7 të nenit 113 të Kushtetutës, në nenet 20 dhe 47 të Ligjit dhe me rregullat 34 (2) të Rregullores së punës, më 4 shtator 2024, njëzëri

VENDOS

- I. TË DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;
- II. T'UA KUMTOJË këtë aktvendim palëve;
- III. TË PUBLIKOJË këtë aktvendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me paragrafin 4 të nenit 20 të Ligjit;
- IV. Ky aktvendim hyn në fuqi në ditën e shpalljes në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës, në pajtim me paragrafin 5 të nenit 20 të Ligjit.

Gjyqtarja raportuese



Remzije Istrefi-Peci



Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese



Gresa Caka-Nimani